



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Seancë dëgjimore me Ministren e Financave mbi projektligjin për buxhetin e vitit 2020.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Elona Gjebrea, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Edmond Rrushi, Edmond Stojku dhe Elena Xhina.

Mungojnë:

Arben Elezi, Alban Zeneli, Myslym Murrizi, Luan Duzha, Ylli Shehu, Paulin Sterkaj, Artemis Dralo, Antoneta Dhima dhe Nimet Musaj.

Të ftuar:

Anila Denaj - Ministre e Financave

Bekim Murati – Drejtor i A.M.V.V-së

Haki Cako - Drejtor i Përgjithshëm i Emergjencave Civile

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës sot kemi të ftuar ministren e Financave zonjën Anila Denaj, së bashku me drejtorin e Përgjithshëm të Emergjencave Civile ose më saktë drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, zotin Haki Çako, zotin Bekim, drejtor i Agjencisë për Mbështetjen e Pushtetit Vendor në Ministrinë e Brendshme, si dhe zonjën Mimoza Dhëmbi, drejtore e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Zonja Ministre, ju falënderoj personalisht, por dhe në emër të anëtarëve të Komisionit të Sigurisë për prezencën tuaj sot në këtë mbledhje! Patëm rastin që të flisnin pak më parë jashtë kamerave, se nuk ka qenë traditë që ministri i Financave të paraqitej në Komisionin për Sigurinë. Mendoj se në historikun e mbledhjeve të këtij komisioni është hera e parë që paraqitet një ministër i Financave.

Ne e vlerësojmë jo vetëm sepse kemi mundësi të diskutojmë nga afër me ju për buxhetin në përgjithësi, të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes, me të cilat realisht jemi njohur dhe kërkesat e tyre kanë qenë të plotësuara nga ajo që kemi kuptuar, nga diskutimet në këtë komision, por mbi të gjitha ajo që do të na interesonte sot, është se si mundemi ne t'i bëjmë të njohura për të gjitha subjektet që i ngarkon ligji me të tilla detyrime. E kam fjalën për ligjin e ri "Për mbrojtjen civile", që ngarkon me detyrime të gjithë përfaqësuesit e pushtetit vendor, por njëkohësisht edhe një sërë institucionesh qendrore për përballimin e të gjitha emergjencave civile ose siç quhen ndryshe të rasteve që kanë të bëjnë me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Pa vonesë do të doja t'ia jap fjalën Ministres, zonjës Denaj për të na bërë një prezantim të përgjithshëm. Pastaj kolegët nëse do të kenë pyetje, patjetër që diskutimin do ta vazhdojmë në këtë mënyrë.

Anila Denaj - Shumë faleminderit!

E nderuar kryetare e komisionit!

Të nderuar deputetë, në prezantimin e përgjithshëm të projektbuxhetit të vitit 2020 do ta vë theksin te fusha e veprimtarisë që ky komision ndjek dhe kryesisht do të reflektojmë ndarjen respektive në të dyja ministritë: atë të Mbrojtjes dhe atë të Brendshme për të krijuar një qasje drejt pyetjes: çfarë mbulon ky buxhet për të dyja këto ministri?

Së pari, më lejoni të theksoj se Ministria e Mbrojtjes ka një alokim të konsiderueshëm prej 3,2 miliardë lekësh më shumë sesa viti 2019, e krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2019. Duke përmbushur angazhimin e qeverisë shqiptare të ndërmarrë në samitin e Wells-it për të rritur buxhetin e mbrojtjes, i cili në vitin 2024 parashikohet të jetë 2% e PBB-së për të arritur këtë nivel çdo vit do të ketë një rialokim të caktuar të fondeve. Për vitin 2020 kjo arrin në 1,39% e PBB-së, duke vijuar në programin afatmesëm buxhetor me 1,56 % në vitin 2021, 1,74% në vitin 2022. Kjo është e parashikuar në raport me kontributet që japim brenda angazhimit në NATO.

Nëse ndalemi në zëra në veçanti se ku do të konsistojë kjo rritje e fondeve, për Ministrinë e Mbrojtjes, së pari në rritjen me 600 milionë lekë për vitin 2020 për të reflektuar efektin e rritjes së pagave të iniciuara nga qeveria në vitin 2019. Kjo rritje do të përkthehet në një forcë ushtarake më të motivuar në pjesëmarrje, në aksionet e mbrojtjes kolektive dhe kombëtare. Janë 1,6 miliardë lekë më shumë fonde për shpenzime korrente në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, të cilat do të shkojnë në përmirësimin në stërvitje, në uniforma, në pjesëmarrjen në misione në përputhje me standardet e NATO-s. Po ashtu janë edhe 750 milionë lekë më shumë për shpenzimet kapitale në vitin 2020, të cilat përkthehen në projekte të investimeve publike si: pajisje, makineri për Forcat e Armatosura, ndërtime dhe rikonstruksione.

Për sa i përket fushës së sigurisë dhe rendit publik vëmendje e veçantë i është kushtuar Policisë së Shtetit. Përmes këtij projektbuxheti mbështesim nevojat e vazhdueshme për trajnimin e këtyre punonjësve përmes rritjes së buxhetit për shpenzimet e personelit në 889 milionë lekë më shumë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2019. Kjo rritje edhe këtë vit, vitin korrent ka shkuar kryesisht për pagesën e orëve operationale të punonjësve të policisë, duke garantuar lehtësimin e shërbimit të sigurisë dhe të rendit publik përgjatë 24 orëve, si dhe shtesën e punonjësve për të mbështetur reformën e nisur në polici për vlerësimin e figurës së punonjësve. Kjo është një përpjekje e pamjaftueshme për të arritur standardet e rajonit, pasi numri i policisë për banorë është më i ulët se sa e ka rajoni. Në diskutimin me ministrin e Brendshëm ne jemi të ndërgjegjshëm se ky alokim nuk është i plotë sipas kërkesave të tij, por brenda mundësive buxhetore të vitit që vjen, kjo do të shikohet për t'u rritur në vitet në vijim, duke shkuar gradualisht në rritjen e këtij treguesi.

Nëse diskutojmë për investimet publike, ky projektbuxhet mbështet Policinë e Shtetit për të finalizuar projektet e nisura në vitin 2019: projekti i rikonstruksionit të repartit të

RENEA-s me vlerë të plotë rreth 780 milionë lekë, si dhe projekti i blerjeve të armatimeve, të pajisjeve speciale me vlerë të konsiderueshme që prej këtij viti.

Në kuadër të mbrojtjes ndaj risqeve potenciale të sigurisë kombëtare, ndërkombëtare vlen të përmendet edhe mbështetja e Shërbimit Informativ Shtetëror me një fond total prej 250 milionë lekësh më shumë krahasuar me aktin normativ të vitit 2019, fond, i cili reflekton edhe riorganizimin strukturor dhe atë të lidhur me sistemin e pagave për këtë shërbim.

Në raport me mbrojtjen civile, dua të theksoj se kjo e fundit dhe sidomos ligji, i cili përfaqësohet gjerësisht nga disa instrumente, fondi i emergjencave edhe në vitin 2020 është i parashikuar në të njëjtin vëllim sikurse viti 2019.

Ju e përmendët pak më parë kërkesën sesi pushteti qendror mund të kontribuojë në përshtatje me ligjin, por edhe për të kontribuar me pushtetin vendor me më shumë fonde.

Janë 3 instrumente që mund të përdoren përgjatë suportit për emergjencat civile. Jo vetëm në reagimin post, por edhe për të krijuar një platformë shumë të mirë mbështetjeje për të parandaluar. Në këtë aspekt, si në nivelin e pushtetit qendror ashtu edhe atë vendor, të dyja linjat: si ministritë përkatëse, të cilat krijojnë me tavanet e tyre buxhetore programe për të parandaluar emergjencat civile, është diskutuar se është një fond i përcaktuar për të rehabilituar. Në shumë raste e kemi vënë re te Ministria e Bujqësisë apo të tjera që kontribuojnë për parandalimin e emergjencave, sidomos nga përmytjet. Ndërkohë që 1% e PBB-së kalohet si transfertë në pushtetin vendor, i cili sipas zonave me risk më të lartë për emergjencat civile mund të alokojë një fond të konsiderueshëm për këto zona më shumë se sa për zonat e tjera.

Në këtë aspekt, dua që t'i jap përgjigje edhe pyetjes suaj se tavanet buxhetore nuk duhet të shihen vetëm në raport me emergjencat civile pas efektit të tërmeteve apo të përmytjeve, sidomos në raport me këtë të dytën duhet të punojmë për parandalimin dhe ministritë përgjegjëse të linjës kanë tavane buxhetore për këtë program.

Është edhe fondi i rezervës, që përdoret për raste të emergjencës, siç ishte rasti i vitit 2019, në aktin normativ që pasoi edhe situatën e shkaktuar nga tërmeti i shtatorit të vitit 2019. I gjithë fondi i rezervës prej 470 milionë lekësh u alokua te fondi i emergjencave për të plotësuar nevojat që dolën nga kjo situatë.

Në raport me kuadrin e gjerë makro unë e kam përmendur edhe në komisionet e tjera dhe vlen edhe për këtë komision, se viti që vjen ka një ulje në raport me parashikimin në programin afatmesëm, sepse vijmë me një bazë më të ulët në fund të këtij viti.

Në Komisionin e Ekonomisë është trajtuar gjerësisht se si është parashikuar gjenerimi i kësaj uljeje, kryesisht në pjesën më të madhe të saj si rezultat i ndryshimit të disa treguesve, duke filluar nga efekti që ka ulja e ritmit të rritjes ekonomike këtë vit, ku pjesa më e madhe i atribuohet edhe situatës edhe varësisë nga sistemi hidrik dhe energjetik. Të paktën 3 miliardë lekë në raport me parashikimin e të ardhurave janë minus si rezultat i rritjes së PBB-së, por edhe të faktorëve të tjerë, që të parashikuar në fillim të vitit janë poshtë parashikimeve reale me të paktën 13 miliardë lekë. Kjo për vitin që vjen sjell bazën më të ulët, pavarësisht se rritja ekonomike parashikohet në 4,1% do të sjellë një total të ardhurash krahasuar me të pritshim e vitit 2019 me 29 miliardë lekë, i cili ka një diferencë me tavanet buxhetore të parashikuara në projektin afatmesëm për vitin 2020 dhe që reflektohet edhe në disa ulje tavanesh nga parashikimi i projektimit afatmesëm.

Megjithatë ne kemi mundësuar që të gjitha projektet prioritare të realizojnë objektivat e tyre dhe të kemi mundësi që duke synuar realizimin efektiv të të ardhurave vitin tjetër, të mos lejojmë rishikime të mëtejshme të këtyre parametrave dhe mbi të gjitha të atyre fiskalë që parashikohet të jenë brenda angazhimit të qeverisë për të pestin vit radhazi.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Denaj për prezantimin që na bëtë në mënyrë të përmbledhur!

Tashmë ne jemi njohur me projektimin e buxhetit për secilin nga dy institucionet qendrore: Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme. Po ashtu jemi njohur edhe me projektin e buxhetit për SHISH-in.

Kjo është një seancë e hapur dhe kolegët mund të drejtojnë pyetje, nëse kanë edhe për sa i përket buxhetit të këtyre institucioneve, por qëllimi në vetvete i kësaj seance dëgjimore sot është i lidhur posaçërisht me emergjencat civile. Ishte diskutimi për buxhetin e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile ai që na bëri të kuptojmë se na duhej kjo seancë. Në ligjin “Për mbrojtjen civile”, në nenin 22 të tij thuhet: “Çdo ministër dhe drejtues institucioni qendror është përgjegjës brenda fushës së tij të përgjegjësisë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”. Një nga detyrat që këto institucione edhe ato qendrore janë disa, por unë do të lexoj vetëm detyrën që parashikon germa ”b” e pikës 2 të këtij neni, ku thuhet: “Ato duhet të planifikojnë buxhet vjetor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile sipas fushës së tyre të përgjegjësisë shtetërore. Për ministritë përgjegjëse për mbrojtjen civile, për Mbrojtjen, Punët e Brendshme, Transportin, Infrastrukturën, Bujqësinë, Shëndetësinë, Arsimin, Mjedisin, Kulturën planifikimi buxhetor

duhet të jetë nga 2% deri në 4% të totalit të buxhetit vjetor”. Ky është një nga ato detyrime, sepse ligji ka hyrë në fuqi dhe duhet të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit 2020.

Ne patëm këtë gjykim, që të jemi të qartë me njëri-tjetrin, e gjykuam në këtë mënyrë. Ka një mekanizëm më të mirë për përballimin e emergjencave civile. Cili është? Kemi Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, që është kryesisht në rolin e koordinatorit, që ka një buxhet x. Ky buxhet nuk pretendojmë që të përballojë të gjitha emergjencat civile.

Janë bashkitë që janë kryesoret. Shumë mirë që u vu detyrimi që 4% të buxhetit të tyre t’ia dedikojnë mbrojtjes civile dhe që u vunë edhe barrierat që bashkitë ta bëjnë këtë, se prefekti nuk miraton buxhetin e bashkive në rast se ato nuk bëjnë këtë planifikim. Nëse nuk përdoret ky fond ashtu siç është përcaktuar, pasi është me detyrim -përcaktim, ai digjet dhe bashkitë nuk mundet ta përdorin për diçka tjetër.

Mekanizmi tjetër është ky që iu vendos edhe një detyrim ministrive, duke mbledhur të gjitha këto duhet normalisht të kursejnë përdorimin e fondit të kontigjencës, që është një fond më i veçantë, e dimë që është në raste më specifike, nuk është një fond që përdoret zakonisht dhe për çdo rast. Llogaria në fakt dilte vërtet e mirë, le të themi dhe ashtu sikurse e përmendët në fjalën tuaj është një mundësi që jo thjesht të përballohen pasojat e emergjencave, por të krijohet një bazë që tani, që nga ky vit. Nuk pretendojmë që çdo gjë do të ndodhë perfekt, por që këtë vit që vjen, pra vitin 2020 të krijohet një bazë e mirë e mjeteve, të ndërhyrjeve dhe gjithçka tjetër që është e mjaftueshme për të përballuar emergjenca civile.

Pamë në buxhet se shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2020 parashikohen në masën 57 miliardë lekë, po e rrumbullakos, nuk po i them bishtat, që i bie 4% e 57 miliardë lekëve të të gjithë buxhetit që ka pushtetit vendor duhet të shkojnë për emergjencat. Ajo që kemi merak është: a duhet që Ministria e Financave të kontrollojë që çdo institucion që përmend ligji do të dedikojë 2%-4% në buxhet për emergjencat civile? Si do të sigurohemi që ministrinë do ta bëjnë këtë gjë? Në çdo rast ky fond nëse do të lindë nevoja për emergjenca që ndodhin në fushën e tyre, do të përdoret për këtë qëllim? Pra, ky ishte qëllimi i diskutimit. Edhe bashkitë të kuptojnë se kanë një detyrim, të cilit nuk mund t’i shmangen më, por edhe ministrinë, pavarësisht se nuk ka kush i penalizon (në kuptimin që nuk ka një organ tjetër që miraton buxhetin e tyre si në rastin e prefektit), por edhe ata duhet të kuptojnë që Ministria e Financave, në gjykimin tonë është autoriteti që vigjilon në një farë mënyre për përmbushjen e këtij detyrimi që përcjell ligji.

Kjo është situata dhe, ju lutem, na thoni nëse jemi drejt në mënyrën se si arsyetojmë.

Anila Denaj – Zonja kryetare, është e saktë, jo vetëm se është një detyrim ligjor, por, mbi të gjitha, se ai detyrim ligjor krijon parakushte për të përmirësuar infrastrukturën në disa dimensione dhe për të ulur risqet në vijim me Ministrinë e Financave për këtë proces, i cili ka dy vjet që monitorohet. Ne nuk kemi tregues të veçantë për të thënë se cila ministri është poshtë 2%-shit si vlerë minimale, megjithatë mund të themi që ka ministri, të cilat e kanë më të tejkaluar.

Do të marr rastin e Ministrisë së Bujqësisë dhe do të përmend disa nga projektet e saj për vitin 2020, në raport me atë që ne gjykojmë si masa parandaluese. Të njëjtën gjë mund të bëjmë edhe me Ministrinë e Infrastrukturës, sepse janë dy ministri të cilat në masën e kontributit që japin për fushën e veprimtarisë së tyre mund të krijojnë një impakt edhe më të madhe se 4%.

Në listën e projekteve të Ministrisë së Bujqësisë kemi një zë të veçantë, infrastruktura e mbrojtjes nga përmbytja, i cili në vitin 2020 parashikon 390 milionë lekë.

Detajet janë të lidhura me mbrojtjen e lumit Vjosa në zonën e Selenicës, argjinaturën e lumit Shkumbin, rehabilitimi i argjinaturës së lumit Buna, mbrojtjen e urës së Zemblakut dhe disa zëra të tjerë, sikurse gati 1 miliardë lekë në vitin 2020 është fondi për objekte të bashkive, të cilat kalojmë me VKM dhe lidhen me diga të ujëmbledhësve në disa zona, si Tapizë, Shoshaj, Kurian, Paskuqan, Kukas, Arapaj, Spitallë dhe është një listë e gjatë, për të cilën vlefata 1 miliardë lekë është e konsiderueshme.

Në zërin e infrastrukturës kemi ura, të cilat për arsye edhe të reshjeve mundet të jenë të dëmtuara dhe rehabilitimi i tyre, në vleftën e 300 milionë lekëve, parashikohet si një zë i veçantë në Ministrinë e Energjetikës dhe Infrastrukturës.

Monitorimin e Ministrisë së Financave dhe krijimin e një raporti të veçantë, unë e gjykoj të drejtë dhe mund të jetë pjesë e relacionit në vijim, kështu që e marrim këtë si një përgjegjësi për ta monitoruar. Siç e thashë edhe më parë, ky është një obligim i çdo ministrie për ta parashikuar në projektbuxhetet e tyre dhe obligimi ynë është për ta monitoruar.

Ermonela Felaj – Në fakt, vetëkuptohet, se janë përgjegjësi të ndërlidhura. Është një përgjegjësi që rrjedh nga fusha specifike që ato mbulojnë, por edhe një përgjegjësi që vjen për shkak të ligjit për mbrojtjen civile.

Secili nga kolegët që ka pyetje për ministren mund t'i bëjë.

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Ministre dhe përfaqësues të ministrisë!

Unë kam disa pyetje, që faktikisht lidhen edhe me ministrinë, por edhe me AKMC-në.

Si paraqitet realizimi i pritshëm i buxhetit të emergjencave civile për vitin 2019?

Sa është financimi i kryer nga ana juaj për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara nga tërmeti i qershorit në Floq?

Kam një korrespondencë me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe energjisë në lidhje me pagesën e dëmshpërblimeve nga tronditjet e tokës në dy bashki, Patos dhe Roskovec, sipas së cilës thuhet se Ministria e Financave ia ka deleguar Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Emergjencave Civile për ta ndjekur.

Sipas informacionit që kam është bërë vlerësimi nga ana e EKB-së dhe, njëkohësisht, në komision kanë qenë edhe përfaqësuese të emergjencave civile, ka dalë edhe vlera, të cilën ua kemi referuar.

Unë doja të dija, a është parashikuar në buxhetin e vitit 2020 likuidimi, pasi deri tani është likuiduar vetëm pjesa e shtëpive të dëmtuara 100%, ndërsa shtëpitë e tjera të dëmtuara në masën mbi 40% nuk janë dëmshpërblyer?

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Ministre!

Anila Denaj – Unë nuk do të shkoja dot deri në detaje, sepse një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve është për kolegët, të cilët mund të bëjnë një raportim, në raport me procedurat se në çfarë faze janë duke u vlerësuar efektet në këtë zonë të dëmtuara.

Në dijeninë e Ministrisë së Financave nuk kanë ardhur akoma raportimet e plota.

Siç e thashë pak më parë, në raport me fondin e emergjencave civile ky vit pati rritje prej fondit rezervë dhe, sigurisht, edhe vitin që vjen, duke shpresuar që nuk do të kemi nevojë, për në çdo rast, fondi rezervë është 1,7 miliardë lekë, nga të cilat 300 milionë lekë janë për reformën në drejtësi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Çako, nëse mund ta plotësoni përgjigjen!

Haki Çako - Faleminderit!

Më duhet të sqaroj se ligji nr. 45 “Për mbrojtjen civile”, i miratuar në korrik të vitit 2019, parashikon fillimin e të gjitha detyrimeve të tjera më 1 janar 2020.

Në këto kushte, ashtu sikurse e përmendi edhe kryetarja, neni 22, përcakton detyrimin e të gjithë institucioneve për të parashikuar në buxhetin e vet 2-4%. Gjithashtu, dua të sensibilizoj edhe të gjitha bashkitë, të cilat deri tani nuk e kanë perceptuar si duhet çështjen e

parashikimit buxhetor. Bashkitë janë të detyruara të parashikojnë jo më pak se 4% të buxhetit të alokuar nga Ministria e Financave në adresë të njësive të pushtetit vendor, në rastin konkret të të gjitha bashkive.

Në këtë aspekt, unë jam më se i qartë dhe i bindur, sikur e tha edhe ministrja, që një pjesë e konsiderueshme e institucioneve kanë fushën e tyre të përgjegjësisë së investimeve që lidhen me reduktimin e riskut, me parandalimin e një sërë fenomeneve të fatkeqësive natyrore, të cilat karakterizojnë vendin tonë. Një vëmendje të shtuar lidhur me këtë çështje ka fakti se edhe nga raporti i BB-së, një dollar përpara se të ndodhë një fatkeqësi, kursen 7 dollarë në momentin e menaxhimit të këtij fenomeni.

Ne kishim para dy ditësh një mbledhje këtu lidhur me buxhetin. Buxheti është i parashikuar, i përcaktuar ashtu sikurse e theksoi edhe zonja Ministre. Mund të them dhe ta ritheksoj se Ministria e Financave për vitin 2019 ka akorduar një shumë të konsiderueshme, ndryshe nga të gjitha vitet e tjera.

Vlera totale e akorduar dhe e vënë në funksionim për emergjencat civile gjatë vitit 2019 shkon gati 1,017 miliardë lekë, që ka të bëjë me përgjigjen në kohë ndaj fenomeneve të fatkeqësive natyrore, siç ishte tërmeti i 1 qershorit në Korçë, po ashtu edhe tërmeti i 21 shtatorit, i cili përfshiu rajonin e Durrësit dhe të Tiranës. Qeveria, bazuar edhe në fjalën e Kryeministrit, akordoi 470 milionë plus 100 milionë që i pati në gjendje buxheti i emergjencave civile. Është filluar procesi i rindërtimit dhe rikonstruksionit të banesave në 6 bashkitë kryesore, Durrësit, Shijakut, Krujës, Kavajës. Rrogozhinës dhe bashkisë së Kamzës.

Në këto kushte më duhet të theksoj edhe një herë se AKMC-ja është e lidhur ngushtë me buxhetimin e institucioneve, por, në mënyrë të veçantë, të bashkive, pasi buxheti i planifikuar i mbrojtjes civile është një buxhet, i cili i adresohet të gjithë sistemit të mbrojtjes civile dhe jo një institucioni.

Lidhur me ecurinë e punimeve në Korçë, mund të them se jemi në fazën përfundimtare të rindërtimit dhe të rikonstruksionit të të gjitha banesave, të përcaktuara nga komisionet përkatëse në bazë të ligjit dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.329 “Për rehabilitimin e zonave të goditura nga fatkeqësitë natyrore”.

Në rastin konkret, të gjitha dosjet e tjera, pasi një numër i konsiderueshëm familjesh apo banesash të dëmtuara pjesërisht ose lehtë kërkojnë një procedurë tjetër, kërkojnë një kompensim të vlerës (50% të vlerës së dëmit të përlllogaritur) dhe janë ende në proces dhe do të duhet një fazë tjetër që të veprojmë hap pas hapi, që të bëhet trajtimi dhe akumulimi i të

gjithë detyrimit lidhur me këtë (do të mbartet edhe me detyrimet e tjera të AKMC-ja i ka ndër vite).

Pra, trajtimi i tyre do të bëhet hap pas hapi. Nuk mundet që të bëhet shlyerja e menjëhershme e të gjitha detyrimeve që ka.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ju na i thatë këto edhe gjatë seancës dëgjimore që patëm me ju, që pjesa më e madhe e shtëpive që duheshin rindërtuar janë kryer dhe kanë mbetur vetëm pak gjëra.

Urojmë që edhe me pjesën e mbetur të ecet shpejt!

Urdhëroni, zoti Harusha!

Luan Harusha - Faleminderit!

Kam dy pyetje që lidhin me qytetin e Shkodrës.

A është menduar për dëmshpërblimet e atyre familjarëve që ka 8 vjet që u është marrë prona për t'u bërë një bajpas, që ka 8 vjet që ka filluar dhe akoma nuk ka përfunduar? Njerëzit paguajnë taksa për pronën që u është marrë. Kanë bërë shkresë pas shkrese dhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Ai bajpas është bërë në kohën e përmbytjeve, për mbrojtjen e qytetit nga përmbytjet, por sot qyteti përmbytet më shumë se dikur. Mblidhen të gjitha ujërat aty, nuk ka asnjë sistem kullimi, pra ka mbetur si një problem i pazgjidhur tash 8 vjet.

Ka edhe një problem tjetër, se në kohën kur u është marrë prona qytetarëve çmimi kaq qenë dyfish më i lartë se sa sot. Ka dalë një VKM para 2 vjetësh dhe çmimi është përgjysmuar.

Përveç qytetarëve, edhe unë kam bërë një shkresë te ministria juaj para disa kohësh dhe nuk kam marrë asnjë përgjigje.

Ermonela Felaj – Po ia jap fjalën edhe zotit Vorpsi se është në të njëjtën linjë.

Pyetjet janë konkrete, prandaj, nëse nuk disponohet informacioni tani, mund të përgjigjeni edhe më vonë.

Sadi Vorpsi - Faleminderit!

Në vazhdim të pyetjeve që bënë kolegët, theksoj se AKMC-ja, me ligjin e ri, patjetër që ka trashëguar edhe një detyrim të mbartur gjatë kohës që kjo agjenci ka qenë drejtori e përgjithshme e emergjencave civile pranë Ministrisë së Brendshme.

Ky detyrim sot është në një vlerë prej gati 7 milionë dollarë. Ne jemi ligjvënës dhe përballemi përditë me kërkesat dhe të drejtat e këtyre njerëzve. Ky fond prej 7 milionë dollarë kur do të ezaurohet?

Kjo është një e dhënë e saktë që nuk e di nëse e keni ju apo jo, por është një e drejtë e atyre qytetarëve, ashtu sic tha edhe zoti Harusha, për ta marrë këtë kompensim të bartur ndër vite.

Unë nuk e di a e keni parashikuar, por nga informacionet që kam unë, parashikimi ose është modest, ose nuk është fare, pa diskutuar akoma aktvlerësimet që do të jenë edhe për shkak të situatës që kaluam, për shkak të tërmetit. Besoj se do të kemi mbivendosje të tjera, në raport me detyrimin karshi qytetarëve.

Pyetja e dytë. Edhe si sekretar i Nënkomisionit të Vetingut në Policinë e Shtetit, mendoj se kemi hasur një ngërç, kjo edhe për shkak të mbivendosjes në këtë komision. Them mbivendosje, sepse ata tridhjetë anëtarë të Komisionit të Jashtëm, sot nuk kanë mundësi të bëhen edhe këshilltarë ligjorë, edhe këshilltarë ekonomikë, e në këtë mënyrë po cenojnë edhe afatin ligjor, që është nga qershori një vit, kjo vetëm për shkak se, përveç logjistikës, kanë probleme edhe me një numër të caktuar punonjësish. Pra, po cenohet procesi i vetingut dhe afati kohor, ndërkohë që pas një viti do të vijmë prapë këtu, për të kërkuar prapë një shtesë, e ndërkohë prapë do ta dëmtojmë parane publike. Këtë jua kërkoj edhe si sekretar i nënkomisionit, për ta pasur në vëmendje, për të bërë një shtesë, me qëllim që ky numër punonjësish t'i atashohet këtë komisioni kaq të rëndësishëm për vetingun në polici.

Këto dy pyetje kisha, që si të thuash, janë edhe një lloj kërkesë imja për këtë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në fakt, të dyja pyetjet u janë bërë edhe drejtuesve të tjerë, që janë paraqitur në këtë komision, por realisht do të isha për dy pyetjet e fundit që bëri zoti Vorpsi. Besoj se janë dy pyetje të rëndësishme për punën tonë, e para, se si mendoni ju, nga pozitat e njeriut që drejton politikën financiare, që të mund ta shlyejmë këtë borxhin e mbartur, borxh prej 722 milionë lekësh, se po shprehem në lekë, jo në monedhë tjetër. Pra, si mund të gjejmë një rrugë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aq është, aq. E ka thënë disa herë.

Pyetja e dytë, pastaj, lidhet me një tjetër përgjegjësi që ne kemi për të monitoruar zbatimin e ligjit për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Sa për t'ju futur pak në temë, sepse realisht nuk është fusha juaj e përgjegjësisë, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, i cili është një komision që mbledh kapacitete intelektuale nga jashtë Policisë së Shtetit, ka detyrimin që, brenda një viti të bëjë vetingun e 237 funksionarëve të lartë të Policisë së Shtetit, sepse pjesën tjetër policia do ta vijojë vetë, nëpërmjet Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Kur e vendosëm afatin, e vendosëm me qëllim që ky komision të veprojë në kohë optimale dhe të japë rezultate të punës konkrete. Sepse, normalisht, nuk kemi asnjë interes si qytetarë, si ligjvënës po e po, që trupa e policisë të ndjehet e shfokusuar nga detyrat e veta, me merakun se si do ecë procesi i vetingut.

Nga ana tjetër, e gjithë kjo ka edhe një pagesë, në fakt. Ju vetë thatë se edhe në fondin e kontigjencës, por është për organet e vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët, keni parashikuar një punë. Pra, është diçka që, si proces, i kushton shtetit. Ashtu si dhe më parë, me ata që bëjnë vetingun e gjyqtarëve e të prokurorëve, edhe trupa që po kryen vetingun e policisë, ndeshen me kërkesën për buxhetim të pamjaftueshëm. Edhe dje na erdhi një kërkesë, të cilën ia bëmë prezente edhe ministrit të Brendshëm, se ishte këtu, nëpërmjet së cilës ata kërkojnë 15 vetë shtesë.

Nuk e di pse Komisioni i Jashtëm nuk jua ka dërguar shkresën edhe juve, por Ministrisë së Brendshme dhe neve na e kanë drejtuar. Kërkojnë pesëmbëdhjetë vetë shtesë, duke arsyetuar se, me kapacitetet që kanë dhe volumin e punës që kryejnë në fakt, se puna që kryejnë ata nuk është e njëjtë, ose më mirë të themi, vetingu i policisë nuk ka po atë mbështetje që ka vetingu për gjyqtarët e prokurorët. Sepse, në rastin e gjyqtarëve e të prokurorëve, ILDPKI-ja, DSIK-ja, SHÇBA-ja janë të detyruara t'i japin material, ndërsa në rastin e vetingut të policisë nuk është i njëjti mekanizëm. Për shembull, në lidhje me kontrollin e pasurisë, ata duhet të investohen vetë. Kanë ca vështirësi, të cilat duhen njohur e duhen mirëkuptuar. Nëse duam të sigurohemi se kjo punë do të bëhet brenda një viti, dhe këta 237 vetë të gradave të larta të përfundojnë deri në qershor, gjë që duket pak e vështirë, për hir të së vërtetës, kështu siç ka ecur procesi. Do të duhet të shikohet e të auditohet kjo gjë, si dhe të kuptohet nëse kjo nevojë që ata paraqesin për pesëmbëdhjetë vetë shtesë është reale. Që na intereson kryerja e punës në afat, patjetër që na intereson, që edhe të mos shpenzojmë më lekë për mbajtjen e kësaj trupe, sepse është e kushtueshme, sepse, nuk kërkojnë vetëm pagën, por kërkojnë edhe gjëra të tjera, por po ashtu na intereson që as policia të mos rrijë gjatë në këtë proces. Një vit merr vetingu konkret, një vit ka marrë historia nga ligji te ndryshimet e të gjitha me radhë, dhe bëhen dy vjet.

Këto dy pyetje, por edhe pyetjen e zotit Harusha, në lidhje me bajpasit e Shkodrës.

Faleminderit!

Anila Denaj – Po e nis nga pyetja që lidhet me numrin shtesë të punonjësve, meqenëse është një pyetje, e cila adresohet dhe shpejt, si zgjidhje për vitin që vjen. Jemi duke parë gjithë rritjet e personelit, referencë që i bëhet programit planifikim, menaxhim e

administrim, dhe është reflektuar një rritje prej tridhjetë personash. Nëse ky numër personeli është ai, i cili do të realizojë me kontratat shtesë këtë veting, do të thosha se është i plotësuar. Në rast të kundërt, sigurisht angazhohemi, që për objektivin madhor që ai ka, ta konsiderojmë dhe ta shtojmë.

Së dyti, në raport me detyrimet e prapambetura të dy çështjeve, si të asaj që lidhet me shpronësimit, ashtu edhe të asaj që lidhet me detyrimet, të cilat i njeh ligji i emergjencave civile.

Në kuadër të një buxheti të caktuar, të limituar sipas tavaneve buxhetore, ka nevojë të shihet se si do të trajtohen detyrimet e prapambetura, jo vetëm ato ndaj individëve, por edhe ndaj bizneseve, në raportin e kontratave të fushave të tjera. Është kërkuar që çdo ministri linje, përpara se të hapë çdo program të ri, të shlyejë detyrimet e prapambetura. Kjo është qasja, në të cilën këmbëngulim në politikën tonë, ne si Ministri e Financave, para se të vijojmë më tej.

Në rastin e shpronësimeve, në total, jo vetëm në rajonin e Shkodrës, por dhe në të gjitha zonat ku ka ende detyrime të prapambetura, sidomos për rrugë e infrastrukturë rrugore, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës është vlerësuar një shumë totale prej 2, 8 miliardë lekësh. Brenda këtij viti është projektuar krijimi i një agjencie të posaçme, me kërkesë edhe të zotit Kryeministër, për të trajtuar të gjitha shpronësimet për interes të punëve publike, që në momentin kur bëhet një vepër publike, të ketë dy mundësi, të adresuara nga kjo agjenci. E para, shpronësimi dhe vlera e shpronësimit, qoftë edhe si pjesë informacionit për analizën financiare, po mbi të gjitha për mënyrën si do të shlyhet. Kjo për vijimin. Ndërsa për 2, 8 miliardët e akumuluar, është menduar që agjenci ta trajtojë me plan pagese brenda një harku kohor 5 deri në 10 vjet, duke paguar edhe norma interesi për çdo detyrim të prapambetur, të rënë dakord midis dy palëve.

Besoj se brenda këtij muaji detajet e kësaj VKM-je dot vihen shumë shpejt në dijeni të publikut, sepse VKM-ja është përgatitur dhe është gati për miratim.

Luan Harusha – Ka tetë vjet që është bërë përllogaritja e dëm shpërblimit. Pas tetë vjetësh do të filloni të krijoni edhe një herë agjenci për këta familjarë. I ka dalë çmimi, i kanë dalë të gjitha, i kanë shkuar edhe letrat, e tashti duhet të fillohet edhe një herë nga e para? Po 50-60 familje janë, 5-6 milionë lekë të vjetra kanë për të marrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk mundet të fillohet prapë nga e para, pas tetë vjetëve.

Anila Denaj – Ne nuk po diskutojmë vlerësim, por po diskutojmë pagesë. Më lejoni të them se këto janë detyrime, sigurisht të prapambetura, të cilat duhej të ishin trajtuar me kohë. Unë nuk jam kundër qasjes që ju keni. Në kushtet e një detyrimi të tillë, kur palët bien dakord për ta paguar me këste atë detyrim, brenda një harku kohor të caktuar, se nuk po themi ë të gjitha kontratat të jenë për dhjetë vjet, mund të jenë kontrata për dy vjet, për shuma të vogla, por mund të ketë edhe shuma të konsiderueshme, që tavanet buxhetore të ministrisë përgjegjëse, në rastin konkret Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës nuk i përmban. Në këtë pikë, detyrimisht, kjo nuk është një marrëveshje që fillon nga e para, pasi nuk do të ketë vlerësim të detyrimit, por është një mënyrë, një modalitet pagese në lidhje me detyrimin e prapambetur, detyrim i prapambetur, i cili do të trajtohet nga agjencia, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Ne, si Ministri e Financave dhe Ekonomisë, sigurisht që do të synonim që çdo detyrim të paguhet brenda tavanëve buxhetore, por tavanet buxhetore kanë projekte, të cilat për arsye nga më të ndryshmet mund ta kenë vonuar vlerësimin, mund të ketë pasur probleme dokumentacioni. Në lidhje me këtë, unë nuk jua jap dot përgjigjen, sepse nuk e menaxhoj unë pjesën e dokumentacionit, se përse zona e Shkodrës nuk i ka marrë në kontekst dokumentacioni. Në qoftë se është në çështje financiare, atëherë duhet të merret individualisht secila pjesë e detyrimit të shpronësuar, dhe do të vendoset: kjo është brenda këtij viti, kjo është brenda gjashtë muajve, kjo është brenda tetë muajve.

Objektivi i krijimit të agjencisë është për të mos lejuar më mbajtjen pezull të këtij procesi. Pra, jo për ta nisur prapë nga fillimi, po për të bërë të mundur që detyrimet të shkojnë në zero, dhe çdo projekt i ri. Unë besoj se, si qeveria Rama, ashtu edhe qeveritë e tjera, do të bëjnë punë publike, ndaj në vijim, që të mos kemi detyrime të prapambetura, të kemi mundësi që, qysh në momentin e parë, agjencia të ketë obligimin juridik për ta trajtuar që në fillim shpronësimin si një pjesë kontraktuale.

Kjo është arsyeja përse krijohet një agjenci, jo vetëm për të shlyer detyrimet e prapambetura, po edhe për t'i trajtuar shpronësimet me një rëndësi akoma më të madhe për punët aktuale publike dhe për të tjerat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Luan Harusha – Agjencia ka qenë e krijuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po një minutë, pra.

Ermonela Felaj – Dakord, dakord, nuk po ndërhyj në lidhje me këtë pjesë, po ndërhyj vetëm për këtë gjë: që po jepet një zgjidhje, që të njihet detyrimi dhe të fillojë të shlyhet, ndërkohë që deri ditën e sotme...

Luan Harusha – Po detyrimi është njohur, kryetare.

Ermonela Felaj – Jo, jo, të njihet në kuptimin agjencisë. Domethënë, e di pse po ndërhyj në lidhje me këtë gjë?

Luan Harusha – Po ç’lidhje kanë ata persona me këtë agjenci?

Ermonela Felaj – Më dëgjo vetëm për këtë pjesë, të lutem.

Luan Harusha – Po.

Ermonela Felaj – Para se të kishim këtë mandat qeverisës, kemi pasur mandatin tjetër. Në mandatin tjetër qeverisës, pra në atë të mëparshmin, kishte një Ministri për Zhvillimin Urban. Ajo ministri kishte brenda saj një sektor, i cili merrej me shpronësimet. Në katër vjet krijoi një përvojë pune dhe po ecte pozitivisht. Me shkrirjen e institutit urban, kjo çështje u shpërnda. Shumë mirë që po krijohet kjo agjenci...

Luan Harusha – Më fal një minutë! Nuk kanë lidhje me agjencinë e sotme me ata persona, kryetare. Nuk ka lidhje. Unë s’dua të diskutoj për agjencitë, por dua të diskutoj për problemin.

Ermonela Felaj – Ka këtë lidhje: që ne po marrim përsipër ta njohim këtë detyrim dhe ta përcaktojmë për sa kohë do ta bëjmë, se kjo është mënyra e zgjidhjes. Edhe mua më pëlqen që të gjitha shpronësimet të kryhen brenda një dite. Të gjithë ne këtë duam.

Luan Harusha – Po ka tetë vjet. Paguajnë taksat vazhdimisht. Bashkia u merr taksat e një prone që s’e kanë tash tetë vjet.

Ermonela Felaj – Dakord, por kjo është mënyra e zgjidhjes. Ne mund të kemi rezerva për këtë mënyrë zgjidhjeje...

Luan Harusha – Po nuk është zgjidhje kjo. Atyre zotërinjve u është njohur detyrimi, tashti thjesht duhet t’u kthejmë paratë e pronës së tyre. Çfarë t’u njohim tashti? Pas tetë vjetësh t’u themi: ejani edhe një herë për njohje prone?

Ermonela Felaj – Ne kërkuam një përgjigje, dhe përgjigja është kjo.

Luan Harusha – Nuk ka përgjigje, pra. Mua nuk më intereson agjencia. Në buxhet duhet të llogaritet dëmshpërblimi i atyre familjarëve. E njohur është, e dokumentuar është...

Ermonela Felaj – Buxheti nuk është vetëm një nevojë, buxheti është shumë nevoja. Po të ishte një nevojë...

Luan Harusha – Të lutem! Por bëhen me radhë kryetare, nuk merret e fundit para së parës.

Ermonela Felaj – Pikërisht pra, ngaqë ka shumë nevoja për të ndarë, do të vihet dhe një prioritet. Në lidhje me këtë do të gjendet kjo zgjidhje.

Luan Harusha – Zgjidhja është t’u jepen lekët qytetarëve.

Ermonela Felaj – dakord!

Luan Harusha – Po 300 milionë, 400 milionë lekë të vjetra janë, që do t’u jepen shtatëdhjetë familjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – Arsytet pse është vonuar, dhe unë nuk mund të marr përgjegjësi që nuk më takojnë, janë arsye që mund të lidhen si me pjesën procedurale, ashtu edhe me pjesën financiare. Në këtë pikë, ajo që unë marr përsipër të sqaroj, është pjesa se si do të shlyhet këndeje e tutje ky lloj detyrimi. Në rastin e vleftave shumë të madha, sigurisht që të dyja palët mund të bien dakord ta paguajnë dhe ta parashikojnë se sa do të marrin çdo mua apo çdo vit.

Për pjesën që mund të jetë procedurale dhe kur është një kohë e caktuar kur është plotësuar dokumentacioni, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës duhet t’ju japë një përgjigje, që ju të jeni i qartë, por besoj edhe qytetarët e asaj zone. Unë nuk e disponoj informacionin e vonësës, të paktën sa i takon pjesës procedurale.

Luan Harusha – Qytetarët i kanë plotësuar dosjet një për një, shtatëdhjetë familje. Nuk ua kanë marrë dokumentacionin pa plotësuar dosjet. Edhe unë, si deputet i zonës, kam dërguar disa herë shkresa, por nuk kam marrë asnjë përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministria juaj.

Ermonela Felaj – Ministria e Financave nuk e bën shpronësimin, po nuk e inicioi...

Luan Harusha – Po është e iniciuar dhe e mbyllur procedura.

Ermonela Felaj – Të lutem! Procedurën, në mos gaboj, e inicion ministria përgjegjëse. Ministria përgjegjëse, që mund të jetë ajo e infrastrukturës, e propozon në Këshillin e Ministrave, pasi ka marrë miratimin e ministrive të linjës. Me vendim të Këshillit të Ministrave vendoset shpronësimi.

Luan Harusha – Por janë kryer të gjitha procedurat e duhura.

Ermonela Felaj – Ti duhet të dish që ka bashki sot, të cilat nuk orientohen ende drejt ku t’i çojnë praktikën e shpronësimit.

E kemi këtu drejtorin, i cili mund të na e konfirmojë që me shpronësime merret Ministria e Brendshme dhe çojnë praktika shpronësimi për muaj të tërë te Ministria e Brendshme, me idenë që po e merr...

Luan Harusha – A mund të marr përgjigje?

Ermonela Felaj – Kjo është përgjigjja.

Luan Harusha – Ka dy vjet.

Ermonela Felaj – Do të krijojmë një agjenci, po thotë ministrja, e cila do të jetë e dedikuar për këtë çështje dhe do të vendosë që detyrimin ta shlyejë në një kohë të përcaktuar, e cila mund të jetë një vit, një muaj, një ditë, nuk e di, do të jetë në varësi të detyrimit dhe të përgjegjësiave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por do të krijohet... Se si ta zgjidhim? Pra, ne po themi që kemi një problem të mbartur edhe nga koha jonë, edhe nga koha e atyre që kanë qeverisur më parë. Të pretendosh gjëra që u mbartën në dhjetë vjet, hajde se po i zgjidhim në një vit, është e pamundur tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta gënjejnë veten në këtë mënyrë? Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është zgjidhja dhe këtë përgjigje kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, Luan. Në qoftë se ti ke zgjidhje tjetër, në rastin kur të diskutojmë ngritjen e agjencisë dhe detyrimet që do të kemi, propozojë si amendim dhe e diskutojmë.

Luan Harusha – Zonja kryetare, agjencia është shumë mirë, nuk jam kundër ngritjes së saj, por këto janë probleme të detajuara, të mbyllura!

Ermonela Felaj – Atëherë, dy masa ka marrë qeveria, nëse e kuptove drejt ministren.

Luan Harusha – Këto kanë për të miratuar vetëm fondin, për të dhënë lekë.

Ermonela Felaj – E para, nuk do të hapë program të ri pa shlyer detyrimet.

E dyta, do të marrë përsipër detyrimin, jo me fjalë, por ligjërisht, pra me përgjegjësi mbrapa, se do ta shlyejë në kaq kohë detyrimin. Dakord?

Luan Harusha – Nuk është normale që sot, pas dhjetë vjetësh, të thuhet: do ta filloj sot, do ta jap me këste.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Patjetër që është normale.

Luan Harusha – Nuk është normale, jo!

Ermonela Felaj – Sepse këto janë situata të paparashikuara dhe, kur ndodhin, normalisht jo në çdo kohë ke buxhet që ta përballosh në atë kohë!

Tani, unë besoj se duhet të kemi mirëkuptim në këtë pikë, në vështirësinë e zgjidhjes...

Luan Harusha – Çfarë mirëkuptimi?! Ka dhjetë vjet që janë marrë prona. Paguajnë taksa dhe nuk u japin lekët e tyre.

Ermonela Felaj – ...dhe në nxitjen që t'i jepet një zgjidhje, jo të rrijë problem i mbartur! Mund të ishim pa një zgjidhje: nuk ka lekë dhe nuk do të shlyhen tani. Unë këtë po them që më mirë të futemi në këtë rrugë dhe të fillojmë t'i zgjidhim një për një të gjitha, sesa të rrimë t'i mbartim vit pas viti dhe jemi në të njëjtën situatë që mbartim dhe nuk ka lekë për t'i shlyer detyrimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, në fakt, do t'ia jap fjalën zonjës Duka dhe pastaj zonjës Malo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, për vetingun e morët përgjigjen, por edhe për atë, është e njëjta përgjigje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – ...milionë lekë dhe cilat janë brenda listës së fondit të emergjencave, unë do të thosha që qasjet mund të jenë dy dhe kjo duhet të shoqërohet me një kërkesë nga institucioni.

E para, brenda institucionit përgjegjës për rritje tavani, dhe këtë disponibilitet nuk e kemi.

E dyta, parashikueshmëria që për një periudhë të caktuar kohe, duke marrë nga tavanet e brendshme ose nga fondi rezervë do të paguhet.

Me këtë përgjigje timen të përgjithshme në raport me qasjen e detyrimeve, nuk dua të shmang përgjegjësinë as si ministre e Financave ndaj detyrimeve, por evidentimi i vleftave edhe në rastin e deputetit në raport jo vetëm me zonën e Shkodrës, por për të gjitha detyrimet që vijnë nga shpronësimet, ashtu edhe me detyrime të tjera, janë ato, të cilat, duke i bërë evidente dhe duke parë tavanet, fillojmë dhe projektojmë, duke filluar nga detyrimet për të vazhduar me projekte të reja. Sepse kjo është mënyra se si mund të menaxhosh, të paktën në këtë situatë, një buxhet kur vjen i mbartur me detyrime dhe kur vjen me projekte.

Projektet e reja janë parë, në këndvështrimin tonë, si Ministri Financash, për të gjitha ministritë e linjës me një nevojë sekondare. Pse? Sepse duam të përfundojmë pikërisht detyrimet e prapambetura, të cilat mund të jenë nga fondi i emergjencave në rastin e 725 milionëshit; 2,8 në rastin e shpronësimeve, si dhe duhet të mësojmë që, në raport me agjencinë, sepse unë e thashë pak më parë, por dua ta theksoj, në mënyrë që të mos kemi detyrime të mbartura, që të ketë njësi të cilat, në mënyrë të vazhdueshme, edhe kur bëjnë analizën e fizibilitetit për një rrugë, ta shikojnë fondin e emergjencave dhe mënyrën e pagesës së tyre brenda projektit, që të mos kemi pastaj mbartje në vijim të detyrimeve që mund të shfaqen.

Ajo është si pjesë e një analize, ashtu edhe një mësim që agjencia do ta tejçojë nëpërmjet planit të saj të punës për rrugë të tjera publike që do të ndodhin. Prandaj kërkohet të krijohet edhe si një ent më vete.

Ermonela Felaj – Atëherë, le të shpresojmë se kjo mënyrë disiplinimi do të fillojë të funksionojë që borxhe të ndryshme, qofshin këto borxhe të prejardhura, si rrjedhojë e emergjencave civile e të tjera, të mund të shlyhen.

Fjalën e ka zonja Duka dhe pastaj ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, pyetja ime shkon për zotin Murati, duke përfutur sot nga prania e tij këtu dhe për ta vënë sërish theksin tek emergjencat civile, si një prioritet që ne e diskutuam për komisionin tonë.

Lidhur me detyrimin që, tashmë, kanë bashkitë për parashikimin në fondin e tyre buxhetor të 4%-shit që duhet të shkojë për emergjencat civile, agjencia juaj, si një agjenci, e cila, në fakt, që nga emri është për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore dhe ka për detyrë të këshillojë si nga ana ligjore, ashtu edhe teknike njësitë e vetëqeverisjes vendore, a ka marrë ndonjë masë specifike që t'i ndihmojë këto bashki në mënyrën se si duhet ta bëjnë këtë planifikim, ose t'ua kujtojë që duhet ta bëjnë këtë planifikim? Sepse kemi bashki të kategorisë së dytë dhe të tretë që, me thënë të drejtën, ndoshta as e dinë fare se duhet ta bëjnë këtë parashikim ligjor për të mos pasur problematika, si, për shembull, për t'u kthyer buxheti nga prefekti. Cilat janë masat e marra konkretisht nga ju, në mënyrë që ky 4% të jetë i parashikuar nga çdo buxhet i çdo bashkie?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Duka!

Bekim Murati – Faleminderit!

Sigurisht, është në objektin e punës së agjencisë që t’ia bëjmë të qartë të gjithë nivelit vendor pasqyrën e buxhetit të vitit 2020. Sigurisht, jemi njohur me ligjin “Për mbrojtjen civile” dhe nenin përkatës, i cili parashikon 4%-shin, por do të duhet theksuar që 4%-shi do të vijë si pasojë e transfertës së kushtëzuar që qeveria shqiptare do t’i alokojë nivelit vendor. Pra, në këtë pjesë buxheti nuk është miratuar ende, është në diskutim. Ne po diskutojmë me nivelin vendor, ku ka pasur problematika të ndryshme nga disa bashki, të cilat nuk arrijnë dot të absorbojnë detyrimin 4% për ta përmbushur, pasi normalisht, krahas tij, me ligjin nr. 139 të pushtetit vendor, si ligj organik ata kanë një detyrim tjetër, që do të duhet të kenë edhe një 3%, si fondin e tyre të parashikuar për fond kontingjence, që do të duhet të quhet.

Kështu, duke qenë se mbetemi përballë dy parashikimeve të ndryshme, sigurisht ligji “Për mbrojtjen civile”, edhe me debatin që patëm qoftë në komision, kur u miratua ligji, apo edhe në diskutimin që patëm në nivel vendor me bashkitë, e pamë të arsyeshme që ky 4% do të vijë si pasojë e transfertës së pakushtëzuar. Kjo transfertë tashmë i ka shkuar nivelit vendor dhe besoj që të gjitha bashkitë, nga kontaktet që kemi, kanë filluar të përgatisin buxhetet e tyre. Ky do të jetë patjetër një detyrim që do të duhet ta përmbushin. Sigurisht, ajo pastaj shtrihet në kohë, sepse nuk është i parashikuar brenda vitit 2020, por shkon deri në vitin 2021 e me radhë.

Kështu që ne jemi të përgatitur, por, ndërkohë, kemi shqetësime nga niveli vendor. Ky ishte diskutimi që patëm pak përpara edhe me drejtorin, edhe me zonjën ministre, sikurse do të duhet të gjejmë edhe një rrugë që ky proces të ecte më mirë. Sigurisht, kur flasim për bashkitë, pastaj ka probleme shumë më të mëdha se kaq, por që nuk janë objekt i diskutimit të sotëm.

Ermonela Felaj – Zonja Malo, nëse më lejoni, kishte një ndërhyrje vetëm për pikën e transfertës së pakushtëzuar, që është më shumë një sqarim teknik, që kërkon ta bëjë sekretarja e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, zoti Murati, ju thatë që tek transferta e pakushtëzuar është planifikuar fondi për emergjencat civile për njësitë e qeverisjes vendore. Unë kam përpara tabelën nr. 3, ku jepet transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2020, por nuk e shikoj këtë si funksion të përfshirë në këtë tabelë për transfertën e pakushtëzuar për pushtetin vendor. A mos ky parashikim është brenda buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në tabelën e grantit të pakushtëzuar, që u është deleguar bashkive, dhe te funksionet që u janë dhënë bashkive pas zbatimit të reformës administrativo-territoriale, nuk ka fond të planifikuar për emergjencat civile.

Ligji, në nenin 22 të tij, parashikon se duhet të akordohet një fond 2% deri në 4% të totalit dhe prefektët e qarqeve nuk miratojnë buxhetet e bashkive nëse ky fond, në formën e grantit të pakushtëzuar, u është akorduar bashkive dhe bashkitë nuk e kanë të destinuar për emergjencat civile. Prandaj, zoti Murati, nuk e di se për çfarë e kishit fjalën.

E dyta, unë bëra një pyetje konkrete në fillim të fjalës sime, para se ta merrja tani, për dëmshpërblimet e 1036 familjeve, të cilin, normalisht, unë e kam shqetësim ditë për ditë. Jemi në periudhën e dimrit, familjet kanë probleme me banesat e tyre nga lagështira, nga problemet atmosferike, prandaj dua një përgjigje konkrete: a është parashikuar, apo jo, në buxhet? Sepse, në qoftë se ne flasim për tërmet në qershor dhe në shtator, atje faktikisht nuk ishte nga Zoti, por ishte nga dora e robit. Kështu që ata njerëz kërkojnë një përgjigje konkrete, se kur do të merret dëmshpërblimi për shtëpitë e dëmtuara në Bashkinë e Roskovecit dhe në atë të Patosit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Moza, kam përshtypjen se e gjithë pyetja është për ty, sepse iu referua tabelës që shoqëron projektligjin “Për buxhetin”. A mund të na bësh një sqarim sa më pak teknik, në mënyrë që ta kuptojmë të gjithë dhe të mos kemi dyshime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni pyetje edhe juve? Në rregull, bëjeni edhe ju pyetjen.

Artemis Dralo Malo – Sepse është pak a shumë në të njëjtën vazhdë, kështu që e marrim përgjigjen të përbashkët.

Në fakt, shqetësimi që dua të ngre sot nuk ka të bëjë konkretisht me dëmshpërblimin, por me rrezikun e jetës së disa banorëve në qytetin e Gjirokastrës. Rishtazi dhe konkretisht, pas reshjeve të fundit (ky problem ka ndodhur që vitin e kaluar), për shkak të tokës shtufore që Gjirokastra ka në disa zona, kanë rrëshqitur dy pallate në dy zona, ku tashmë është bërë një problem shumë i madh. Këta banorë dhe bashkia konkretisht kanë depozituar projektet që vitin e kaluar, edhe sivjet sërish për të dyja këto pallate, për të dyja këto zona dhe është me rrezik shumë të madh për jetën e banorëve, sepse pallati rrezikon të shembet, dhe nuk është hera e parë që diçka e tillë ndodh në Gjirokastrë. Por Bashkia e Gjirokastrës nuk ka marrë asnjë dritë jeshile minimalisht për profilaksinë, nuk po themi për të rindërtuar ose për t'i

shpërblyer ata banorë me banesat e tyre, sepse ky fond është shumë i madh dhe jemi koshientë për situatën. Por bëhet fjalë për rrezikun e jetës së shumë familjeve në këto dy kodra të qytetit të Gjirokastrës. Çfarë ka parashikuar buxheti i fondeve të emergjencave për këtë vit? Nëse mund të kthehet një përgjigje edhe se ku ka ngelur ngërçi i gjithë kësaj situatë, pas depozitimit të projektit?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Po, i mbyllem të gjitha pyetjet me një përgjigje.

Mimoza Dhëmbi – Lidhur me detyrimin e njërive vendore për të parashikuar fondin e emergjencës, ne mendojmë që zgjidhja vjen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, e cila është kolona e parë në tabelën nr. 3. Mbrojtja civile nuk është funksion i destinuar, pasi është pjesë e transfertës së pakushtëzuar. Pra, njësitë vendore, kur të miratojnë detajimin e buxhetit nëpërmjet këshillave të tyre, duhet që në buxhetin e tyre të miratojnë edhe një zë të posaçëm që të quhet fond emergjence. Ai është fond i tyre dhe është brenda fondit të transfertës së pakushtëzuar, do të përdoret po për njësinë e tyre. Pra, mbrojtja civile nuk është ndonjë funksion specifik që sjell një kosto të veçantë.

Nëse ndodh një fatkeqësi natyrore e përmasave madhore, është qeveria pastaj që përgjigjet me fondet e saj. Ndërsa emergjencat e vogla janë pjesë e funksioneve të tyre, nuk është se ky funksion i shkakton një kosto të re.

Detyrimi tani është ta nxjerrë në dukje këtë fond, kur të miratojnë buxhetin e tyre dhe kur prefekti ta miratojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me pallatin e Gjirokastrës, nuk i di gjërat specifike, di se ka pasur një rrëshqitje e pallatit, ka qenë një fond në buxhetin e emergjencave të fondi i investimeve, ai ka kaluar dhe me rialokimet e fundit të dhjetorit, kam idenë se do të mbyllet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, flisni me mikrofon!

Haki Çako – Në fund të vitit 2018 dhe vitit 2019, kodra e Shtufit është financuar nga buxheti i shtetit në vlerën 85 milionë lekë, projekt, i cili, me sa jam në dijeni dhe kam informacion, është gati në përfundim.

Projekti tjetër është i administruar si projekt dhe është në konsideratë për t'u rivlerësuar, për t'u trajtuar financiarisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është parashikuar në mënyrë specifike, por, gjithsesi, është në tërësinë e detyrimeve të parashikuara që unë kam përmendur më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Ermonela Felaj – Nuk e di nëse ka pyetje të tjera nga kolegët, por besoj se u ezauruan të gjitha përgjigjet.

Në përfundim të të gjithë asaj që dëgjuam, mendoj se ndoshta do të jetë e nevojshme që bashkitë të udhëzohen më tej. Ndoshta një udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme, posaçërisht për pjesën që mbulon pushtetin vendor dhe emergjencat. Nuk e di se si do të mund ta konfiguroni këtë udhëzim, por mendoj se ka nevojë për ta sqaruar, pasi, me sa shihet, edhe midis nesh ka diskutime, por që janë më shumë teknike. Meqenëse ajo masë në nivel teknik do të zbatohet, e mira do të ishte që, para se ata të fillojnë miratimin e buxheteve të tyre, të jenë të orientuar drejt se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë penaltitesh kanë, në qoftë se nuk e bëjnë.

Në fund të ditës, ne na intereson që të ketë buxhete të akorduar për këtë pjesë, sepse kjo është realisht një masë parandaluese, një masë mbrojtëse e nevojshme. Sigurisht, do të ketë vështirësi në fillim. Patjetër, nuk ka asnjë ligj të ri që nuk paraqet vështirësi sapo implementohet, madje që në mënyrën se si kuptohet, por kjo nuk është arsye që ne të zmbresemi, përkundrazi, është arsye për ta filluar këtë punë.

Unë ju falënderoj edhe një herë të gjithëve, mbi të gjitha, ministren për predispozitën për të qenë në këtë komision!

Faleminderit! Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

.